



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KwSHILLI I BASHKISW VAU DEJËS



V E N D I M

Nr.38, datë 22/07/2016

“Mbi vlerësimin e dëmeve nga ana ndërtimore të familjes së z.Nikë Palokë Velaj, në fshatin Mëlgushë, Njësia Administrative Bushat

Kwshilli i Bashkisw Vau i Dejës pas shqyrtimit të dokumentacionit të Komisionit të Verifikimit të Dëmeve, konkretisht: Preventivi “*Vlerësimi nga ana ndërtimore e banesës*” të Komisionit të ekspertëve të Këshillit të Qarkut Shkodër (*bashkëlidhur*), si dhe preventivin “*Vlerësimi i dëmeve në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake*”, të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Shkodër”.

Bazueshmëria ligjore: Ligji Nr.139/2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”; Ligji Nr.8756 datë 26.03.2001 “*Për emergjenat civile*” i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.329, datë 16.05.2012 “*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave Nr.263 datë 24.05.2013 “*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*”; Udhëzimit Nr.4 datë 30.09.2015 i KM “*Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015, pas shqyrtimit të Projekt-Vendimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës dhe Sektori i Emergjencave Civile, Kwshilli i Bashkisw Vau Dejës, në mbledhjen e datës 22/07/2016, me shumicë të cilësuar votash,*

V E N D O S I :

1. Të miratojw vlerën e dëmit nga ana ndërtimore në shumën 912,610.25 (*nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dhjetë pikë njëzet e pesë*) lekë sipas preventivit të hartuar dhe të miratuara nga specialistët e Këshillit të Qarkut “*Preventiv për vlerësimin e dëmeve nga ana ndërtimore*”.
2. Të miratojw vlerën e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake në shumën 114,000 (*njëqind e katërbëdhjetë mijë*) leke, sipas shkresës “*Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe paisjeve elektroshtëpiake*” të Komisionit të ekspertëve të Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Të popozojë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhënien e diferencës midis ndihmës financiare të dhënë nga Këshilli i Bashkisë Vau i Dejës me vendimin nr. 31 datë 02/06 /2016 në vlerën 10,000 lekë (*bashkëngjitur*) dhe dëmeve të konstatuara nga ana ndërtimore dhe dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake.

4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015

"Për vetqeverisjen vendore".

U shpall sot me date 26/07/2016.



SEKRETARI
Gentian NDOJ



KRYETARI
Martin MARKU